



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:270215

Datë: 19.12.2024

Numri i dokumentit: 06623083

A-REV.nr. 26/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Zenel Ieku dhe Milena Djerić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, “N. L”. SHPK, me seli në P., kundër të paditurit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, (OSHP), me seli në P., me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.419/24, të datës 24.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 18 Dhjetor 2024, merr:

A K T V E N D I M

Hedhet i palejuar Revizioni i paditësit, “N.L., SHPK, me seli në P., i parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.419/24, të datës, 24.05.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, K.DH.SH.II.nr. 419/24, të datës, 24.05.2024, Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, e datës 28.12.2023 dhe ankesa e paditësit, “N.L”, Sh.p.k., me seli në P., e datës 15.01.2024, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA nr. 23/22, të datës 27.11.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, paditësi për mes përfaqësuesit sipas autorizimit, avokat Fatbardh Makolli në Gjykatë Supreme, në kuptim të nenit 14 të Ligjit për Gjykatën Komerciale nr.08/L-015, parashtron revizion, me të cilin e konteston ligjshmërinë e aktgjykimeve të dy instancave si më lartë, për shkak të; shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim, që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin si të bazuar dhe të ndryshoj aktgjykimet e atakuara në drejtim të miratimit të plotë të kërkesëpadisë.

Gjykata Supreme shqyrtoi revizionin e ushtruar në pajtim me nenin 52.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe gjen se;

Revizioni i paraqitur është i palejuar.

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, K.DH.SH.II.nr. 419/24, të datës, 24.05.2024, Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, e datës 28.12.2023 dhe ankesa e paditësit, "N.L", Sh.p.k., me seli në P., e datës 15.01.2024, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA nr. 23/22, të datës 27.11.2023, vërtetohet, me të cilin në pikën I. të dispozitivit, APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit, "N.L", Sh.p.k., me seli në P., Pika II. KONSTATOHET I KUNDËRLIGJSHËM, vendimi i Panelit Shqyrtues të OSHP, me nr. 303/18, i datës 26.07.2018, për aktivitetin e prokurimit me titull, "Furnizim me artikuj ushqimor për "Spitalin Sheik Zayed" në Vushtrri, me nr. prokurimi 701-18-36-92-1-1, të shpallur nga Autoriteti Kontraktues Qendra Klinike Universitare e Kosovës. III. Refuzohet kërkesa për kompensim të dëmit të shkaktuar si e pa bazuar. V., Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Neni 24 të Ligjit për konfliktet administrative (LKA) përcakton se, kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrojë në Gjykatë Supreme të Kosovës, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale, ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes.

Neni 25 (LKA) përcakton se, *kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës, prokurori publik mund t'i parashtrojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse me vendim të tillë është shkelur ligji, dispozitat e tjera ose akti i përgjithshëm.*

Sipas nenit 50 (LKA), *kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimin të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën. Ndërsa kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitet brenda nëntëdhjetë (90), ditëve nga dita kur u është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa.*

Sipas nenit 13, parag.1., të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet kompetenca e Gjykatës Komerciale, për të gjykuar në shkallën e parë dhe të dytë, ndërsa sipas pikës 1.11, të këtij neni, përcaktohet (kompetenca ekskluzive e kësaj gjykate për të gjykuar), citim, "*kontestet administrative, të iniciuara nga Shoqëritë Tregtare kundër vendimeve përfundimtare të ATK të Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore*". Dhe sipas pikës 1.12, "*kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative*".

Sipas nenit 14 të parag.1., të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet, *“lidhur me kërkesat për mjetet e jashtëzakonshme juridike, kundër vendimeve përfundimtare të Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës, zbatohen ligjet procedurale në fuqi”*.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe dispozitave të cituara si më lartë të Ligjit për Konflikte Administrative dhe nenit 13 dhe 14 par.1, të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë gjen se, kundër vendimeve të formës së prerë për konteste administrative të gjykatës së shkallës së dytë, pra edhe të Gjykatës Komerciale në kontestet administrative nga neni 13, pika 1.11, dhe 1.12, pala mund të parashtrojë në Gjykatë Supreme mjet juridik të jashtëzakonshëm, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa prokurori publik kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Nga theksimet si më lartë rezulton se, me revizion nuk mund të kontestohen vendimet e formës së prerë për konteste administrative të gjykatës së shkallës së dytë, prandaj kjo gjykatë e hedhë poshtë revizionin e parashtruar nga paditësi si të palejuar.

Nga theksimet si më lartë e në pajtim me nenin 52.1, lidhur me nenin 24 dhe 25, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË

A.REV. nr. 26/2024, datë 18 Dhjetor 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani